



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 124, datë 20.3.2014

PËR

MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT BASHKËRENDUES  
PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e përbërjes së Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve, si më poshtë vijon:

- |  |          |   |
|--|----------|---|
| • Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes                                | kryetar; | ✓ |
| • Një përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes           | anëtar;  | ✓ |
| • Një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | anëtar;  |   |
| • Një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë   | anëtar;  |   |
| • Një përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë                                 | anëtar;  | — |
| • Një përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës                          | anëtar;  |   |
| • Një përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit                            | anëtar;  | — |
| • Një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit                                      | anëtar;  | — |

- Pesë përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse që mbrojnë interesat e konsumatorëve anëtarë;
  - Katër përfaqësues nga shoqatat e biznesit anëtarë.
2. Këshilli Bashkëndues për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ushtrojë veprimtarinë në mbështetje të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, dhe të rregullores për funksionimin e këtij këshilli.
  3. Ngarkohen ministrat e përmendur në pikën 1, të këtij urdhri, që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, të caktojnë përfaqësuesit e tyre, në nivel drejtorie, për në Këshillin Bashkëndues për Mbrojtjen e Konsumatorëve.
  4. Urdhri nr.82, datë 3.7.2008, i Kryeministrit, "Për miratimin e përbërjes së Këshillit Bashkëndues për Mbrojtjen e Konsumatorëve", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDIRAMA**

